

## Vendim nr. 73 datë 11.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 11.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (R) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **ROVITO PALOKAJ**, përfaqësuar nga avokat Konstandin Trandafili, me prokurë.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 3252, datë 10.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1246, datë 21.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-2988, datë 04.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**  
**Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me tjetër trup gjykues.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 41, 42, 131, shkronja “f”, 134, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Rovito Palokaj (*kërkuesi*), në datë 27.02.2011, në vendin e quajtur “Fusha e aviacionit ushtarak”, në fshatin Gjadër, Lezhë, ndërsa ka qenë në drejtim të një automjeti, duke lëvizur nëpër pistë, është përplasur me mjetin motor, si rezultat i së cilës drejtuesi i motorit ka pësuar dëmtime që i kanë shkaktuar vdekjen.

2. Për këtë ngjarje, në datën 28.02.2011 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të kërkuesit për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290, paragrafi i parë, i Kodit Penal. Në hetimin paraprak, mbështetur në aktin e ekspertimit autoteknik, prokuroria ka konstatuar se ngjarja nuk ka ndodhur në një rrugë automobilistike dhe të pajisur me sinjalistikën përkatëse, siç përcakton ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku mbi këtë bazë ka konkluduar se kërkuesi nuk ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi penal dhe me vendimin e datës 22.04.2011 ka pushuar hetimet.

3. Automjeti i përfshirë në këtë ngjarje ka qenë në pronësi të kërkuesit, i cili e ka siguruar atë pranë një shoqërie sigurimi sipas një police sigurimi kasko të datës 11.02.2011, me afat mbulimi deri në datën 10.02.2012. Në rrethanat kur në atë ngjarje automjeti ka pësuar dëmtime, kërkuesi i është drejtuar siguruesit për shpërblimin e dëmit sipas kontratës së sigurimit kasko, por megjithëse janë kryer edhe ekspertizat përkatëse për ngjarjen, kërkuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje prej tij. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi duke kërkuar detyrimin e shoqërisë së sigurimit për shpërblimin e dëmit të plotë sipas kontratës së sigurimit kasko, në masën 1 000 000 lekë, si dhe kamatat e arrira të shumës së paakorduar në kohë. Padia është regjistruar në gjykatë në datën 27.03.2013.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3252, datë 10.03.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe prova. Sipas asaj gjykate, kërkuesi nuk ka qenë i mbuluar nga policia e sigurimit për kërkimin objekt gjykimi. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1246, datë 21.05.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Krahas argumentit të parashtruar nga gjykata e

shkallës së parë për rrëzimin e padisë, gjykata e apelit ka vlerësuar edhe se e drejta e kërkuarit për të ngritur padi është parashkuar. Kundër këtij vendimi kërkuari ka ushtruar rekurs.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-2988, datë 04.07.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga kjo dispozitë.

7. Në datën 14.02.2024, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë sipas objektit.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

8. **Kërkuari** ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar të drejtën e pronës, të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe parimin e barazisë para ligjit, të garantuara nga nenet 18, 41 dhe 42, të Kushtetutës. Për sa i takon së drejtës për proces të rregull ligjor, në mënyrë të përmbledhur, ai ka pretenduar se gjykatat e kanë cenuar atë në drejtim të:

- 8.1. *Parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi gjykimi nga Gjykata e Lartë sipas dispozitave procedurale të ndryshuara pas depozitimit të rekursit ka cenuar rëndë parimin e veprimit të ligjit të kohës, në kushtet kur dispozitat e procedurale të kohës e lejonin atë gjykatë të shqyrtonte rekursin si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë material të faktit.
- 8.2. *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka shqyrtuar rekursin dhe ka marrë vendim bazuar në standardin e sotëm të pranimit të rekurseve, ndërkohë që rekursi i kërkuarit është depozituar në vitin 2015, në bazë të parashikimit të nenit 472 të KPC-së së kohës. Kjo mënyrë veprimi e Gjykatës së Lartë ka kufizuar padrejtësisht edhe të drejtën e aksesit për shqyrtimin e të gjitha shkaqeve të ngritura në rekurs. Në këtë aspekt, Gjykata e Lartë ka dështuar në ushtrimin e funksionit të saj rishikues, për sa kohë ka anashkuar shkeljet e kryera nga gjykatat e faktit, që lidhen me cenimin e parimit të kontradiktoritetit, disponibilitetit, të drejtën për t'u njohur me aktet e dosjes dhe asaj për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka anashkuar pretendimin e kërkuarit se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë për një kontratë që nuk është

paraqitur si provë nga pala e paditur dhe që nuk i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, gjë e cila përbën shkelje të rëndë procedurale në kuadër të nenit 472 të KPC-së.

- 8.3. *Së drejtës për t'u njohur me aktet e dosjes*, pasi ai është vënë në dijeni të kontratës së sigurimit kasko vetëm pasi është marrë vendimi nga Gjykata e Lartë, kur është paraqitur për të studiuar dosjen.
- 8.4. *Parimit të disponibilitetit*, pasi gjykata e apelit ka vepruar përtej kufijve të ankimit, duke qenë se ai nuk ka kërkuar shqyrtimin në themel të çështjes, por verifikimin e shkaqeve të ankimit dhe në funksion të tyre vendosjen e ligjshmërisë së vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Pretendimet në ankim kanë qenë për shkelje që cenonin në tërësi procesin. Vlerësimi nga gjykata e apelit se padia është parashkruar, për shkak se është paraqitur përtej afatit 2-vjeçar, cenon parimin e disponibilitetit, për sa kohë ky pretendim ka rënë në dekadencë, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka legjitimuar cenimin e këtij parimi.
- 8.5. *Parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*, pasi kërkuesi është vendosur në pozitë të pafavorshme kundrejt palës tjetër, duke qenë se nuk është njohur asnjëherë me kontratën e sigurimit kasko të pranuar si provë nga gjykatat, pavarësisht kërkesave të tij vazhdueshme gjatë shqyrtimit në gjykatën e shkallës së parë. Mosparaqitja e kontratës nga pala e paditur i bën kushtet e saj të pavërteta, për më tepër kur ato nuk janë konfirmuar as nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), i cili ndonëse u thirr nga gjykata, nuk u paraqit në gjykim.
- 8.6. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe jologjik. Ajo gjykatë, nga njëra anë, pranon shkeljen e lejuar nga gjykata e shkallës së parë në lidhje me mosadministrimin e provës vendimtare, konkretisht të kontratës së sigurimit kasko dhe, nga ana tjetër, ligjëron vendimmarrjet e gjykatave të faktit. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar me hollësi e argumente se përse nuk i merr parasysh pretendimet në rekurs të kërkuesit, ndërsa ka dhënë konkluzione kategorike e të rumbullakosura duke keqinterpretuar faktet dhe ligjin. Gjithashtu, megjithëse Gjykata e Lartë shprehet se shkelja nga gjykata e shkallës së parë është rregulluar nga “riçelja e hetimit gjyqësor” prej gjykatës së apelit, nga procesverbali gjyqësor nuk rezulton një gjë e tillë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

11. Në rastin në shqyrtim, Kolegji çmon se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, në cilësinë e palës paditëse, ku janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi dhe, për rrjedhojë, ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuari, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kolegji vëren se kërkuari kundërshton procesin gjyqësor të nisur prej tij kundrejt shoqërisë së sigurimit, palë e paditur, ku ka kërkuar shpërblimin e dëmit të plotë të automjetit sipas kontratës së sigurimit kasko të datës 11.02.2011, si dhe kamatat e shumës së paakorduar në kohë. Ky proces është përmbyllur me vendimin e Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se

kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi, ndaj kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion konsiderohet i përmbushur.

14. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, pra nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijëni në një datë të ndryshme. Ajo ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijëni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 04.07.2023, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në datën 14.02.2024. Me shkresën nr. 5629/1 prot., datë 01.11.2023, Gjykata e Lartë informon se vendimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 16.10.2023, që është dhe momenti kur kërkuesi konsiderohet se ka marrë dijëni efektivisht për vendimin objekt kundërshtimi. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ankimi kushtetues është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

16. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar të drejtën e pronës, të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe parimin e barazisë para ligjit, të garantuara nga nenet 18, 41 dhe 42 të Kushtetutës. Për sa i përket së drejtës për proces të rregullt ligjor, ai ka pretenduar se është cenuar në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me të drejtën për akses, së drejtës për t’u njohur me aktet e dosjes, parimit të disponibilitetit, parimit të kontradiktorit dhe barazisë së armëve, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

17. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin dhe ka marrë vendim bazuar në standardin e ligjit të kohës, ndërkohë që ai ishte depozituar në vitin 2015 dhe se kjo mënyrë veprimi i ka kufizuar padrejtësisht edhe të drejtën e aksesit për shqyrtimin e të gjitha shkaqeve të ngritura në rekurs. Sipas tij, në këtë mënyrë Gjykata e Lartë ka anashkaluar shkeljet e

lejuara nga gjykatat e faktit që kishin të bënin me kontratën e sigurimit kasko, që nuk është paraqitur si provë nga pala e paditur dhe nuk i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, gjë e cila përbën shkelje të rëndë procedurale në kuadër të nenit 472 të KPC-së.

18. Kolegji konstaton se ndonëse këto argumente kërkuesi i ka përdorur për të mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, në thelb, ato lidhen me pritshmëritë që kërkuesi ka pasur që rekursi të shqyrtohet në përputhje me normat ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së tij. Për rrjedhojë, Kolegji do t'i analizojë këto argumente në këndvështrim të *parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme* të lidhur me zbatimin në kohë të ligjit.

19. Po kështu, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për t'u njohur me aktet e dosjes*, duke parashtruar argumentin se është vënë në dijeni të kontratës së sigurimit kasko vetëm pasi është marrë vendimi nga Gjykata e Lartë, kur është paraqitur për të studiuar dosjen. Gjithashtu, sipas tij, gjykata e apelit ka vepruar përtej kufijve të ankimit dhe se vlerësimi i saj se padia është parashkruar, sepse është paraqitur përtej afatit 2-vjeçar, cenon *parimin e disponibilitetit*, për sa kohë ky pretendim ka rënë në dekadencë, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka legjitimuar cenimin e këtij parimi. Ai ka pretenduar edhe se është cenuar *parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*, pasi është vendosur në pozitë të pafavorshme kundrejt palës tjetër, duke qenë se nuk është njohur asnjëherë me kontratën e sigurimit kasko të pranuar si provë nga gjykatat, pavarësisht kërkesave të tij vazhdueshme gjatë shqyrtimit në gjykatën e shkallës së parë, ndërkohë që mosparaqitja e së cilës nga shoqëria e sigurimit i bën kushtet e saj të pavërteta, për më tepër kur ato nuk janë konfirmuar as nga AMF-ja.

20. Mbështetur në thelbin e këtyre argumenteve, Kolegji vlerëson t'i trajtojë pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njohur me aktet e dosjes, parimit të disponibilitetit dhe parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në këndvështrim të *së drejtës së mbrojtjes*.

21. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e *së drejtës së pronës dhe parimit të barazisë përpara ligjit*, të garantuara nga nenet 18 dhe 41 të Kushtetutës, duke pasur parasysh se qëllimi i procesit gjyqësor të nisur nga kërkuesi ka të bëjë me përfitimin e dëmshpërblimit financiar sipas kontratës së sigurimit kasko, e cila, sipas tij, nuk është administruar nga gjykatat e faktit, Kolegji çmon t'i analizojë ato të ndërvarura nga pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Ky i fundit parashikon se të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor (*pika 1*).

22. Për sa më lart, pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, Kolegji do t'i analizojë në vijim në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, të së drejtës së mbrojtjes dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

*B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*

23. Kërkuari ka pretenduar se gjykimi nga Gjykata e Lartë është zhvilluar mbi dispozitat procedurale të ndryshuara pas depozitimit të rekursit, gjë e cila ka cenuar rëndë parimin e veprimit të ligjit në kohë, në kushtet kur dispozitat procedurale të kohës së paraqitjes së rekursit e lejonin atë gjykatë ta shqyrtonte atë si në aspektin procedural, ashtu dhe në atë material të faktit. Sipas tij, për shkak të mënyrës së shqyrtimit të rekursit, Gjykata e Lartë ka dështuar në ushtrimin e funksionit të saj rishikues për sa kohë ka anashkaluar shkeljet e kryera nga gjykatat e faktit, ndërsa vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë për një kontratë që nuk është paraqitur si provë nga pala e paditur dhe që nuk i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, gjë e cila përbën shkelje të rëndë procedurale në kuadër të nenit 472 të KPC-së.

24. Gjykata ka theksuar se parimi i sigurisë juridike garanton parashikueshmërinë e sistemit normativ. Nxjerrja e normave juridike nuk i shërben vetëm zgjidhjes së një konflikti të mundshëm ose rregullimit të një situatë të parregulluar më parë. Ky proces duhet të krijojë përshtypjen tek subjektet e së drejtës se përmbajtja e normave juridike garanton siguri dhe qëndrueshmëri për të ardhmen (*shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 2, datë 18.02.2013; nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa i takon zbatimin në kohë të ligjit, Gjykata është shprehur se edhe pse Kushtetuta nuk përmban një rregull të veçantë në këtë drejtim, me përjashtim të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues (*neni 29, pika 3*) dhe ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit për taksat, tatimet dhe detyrimet financiare (*neni 155*), zbatimi i ligjit në kohë lidhet me shtetin e së drejtës dhe procesin e rregullt ligjor, në kuptimin që siguria juridike kërkon që kushdo të jetë në gjendje të parashikojë se si zbatohet ligji në një situatë të caktuar (*shih vendimin nr. 1, datë 26.01.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, vepron parimi *tempus regit processum*, sipas të cilit ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 3, datë 11.02.2021; nr. 11, datë 23.04.2009; nr. 11, datë 19.09.1995 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se efekti



prapaveprues i ligjit procedural është përjashtim që vendoset nga ligjvënësi sipas kriterëve specifike, me qëllim që të mos ndikojë në mënyrë arbitrare në të drejtat tashmë të fituara nga të tretët.

26. Kolegji vëren se sipas KPC-së shkaqet për të cilat vendimet e gjykatave më të ulëta mund të ankimohen me rekurs janë parashikuar në nenin 472 të saj, i cili ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 38/2017. Ky ligj, në dispozitat kalimtare (*neni 109, pika 1*), ka parashikuar se çështjet civile që ditën e hyrjes në fuqi të tij janë në gjykim në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadsisë. Ndërkohë, KPC-ja ka ndryshuar sërish me ligjin nr. 44/2021, në dispozitën kalimtare të të cilit (*neni 32, pika 2*) ka parashikuar se rekursit e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre. Ndërkohë, për sa i përket shqyrtimit të rekursit, neni 480 i KPC-së në vijimësi ka rregulluar shqyrtimin paraprak të tij në lidhje me verifikimin e kriterëve të pranueshmërisë, shqyrtim që bëhet në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve.

27. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji vëren se kërkuesi e ka depozituar rekursin në vitin 2015, pra përpara ndryshimit të nenit 472 të KPC-së, ndërsa Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar atë dhe ka dhënë vendimin e saj në datën 04.07.2023, pra pas ndryshimit të kësaj dispozite me ligjin nr. 38/2017. Për rrjedhojë, në përputhje me parashikimin e bërë në dispozitën kalimtare të ligjit nr. 44/2021, vlerësimi i kriterëve të pranueshmërisë së rekursit bëhej sipas parashikimeve të KPC-së në kohën e depozitimit të tij në vitin 2015. Ndërkohë, çështja e zbatimit në kohë të ligjit procedural në lidhje me kriteret e pranueshmërisë për shqyrtim të rekursit ka gjetur trajtim edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar se në rastin e rekurseve, të cilat janë depozituar dhe regjistruar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 44/2021, në funksion edhe të garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse, për efektet e pranueshmërisë së rekursit mbahet parasysh ligji i kohës së regjistrimit të tyre (*shih paragrafin 13 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në vijim, ajo gjykatë ka arsyetuar se rekursi i kërkuetit nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së apo se ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga kjo dispozitë, pasi në gjykimin e çështjes nga gjykatat më të ulëta nuk rezultojnë shkelje të rënda procedurale, të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve, si dhe se nga ato gjykata janë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material (*shih paragrafët 15-16 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

28. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë rezulton të ketë zbatuar ligjin procedural të kohës së paraqitjes së rekursit në lidhje me kriteret e pranueshmërisë së rekursit. Po ashtu, rekursi i është nënshtruar shqyrtimit paraprak, shqyrtim nga i cili Gjykatës së Lartë i ka rezultuar se ai nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme është haptazi i pabazuar.

*C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes*

29. Kërkuesi ka pretenduar se është vendosur në pozitë të pafavorshme kundrejt palës tjetër, duke qenë se nuk është njohur asnjëherë me kontratën e sigurimit të pranuar si provë nga gjykatat, pavarësisht kërkesave të tij të vazhdueshme për paraqitjen e saj gjatë shqyrtimit në gjykatën shkallës së parë. Ai është vënë në dijeni të kontratës së sigurimit kasko vetëm pasi është marrë vendimi nga Gjykata e Lartë, kur është paraqitur për të studiuar dosjen gjyqësore. Ndërsa kushtet e kontratës kasko nuk janë konfirmuar nga AMF-ja dhe mosparaqitja në gjykim e kontratës nga pala e paditur i bën kushtet e saj të pavërteta. Sipas kërkuesit, gjykata e apelit ka vepruar përtej kufijve të ankimit, duke qenë se ai nuk ka kërkuar shqyrtimin në themel të çështjes, por verifikimin e shkaqeve të ankimit dhe në funksion të tyre vendosjen e ligjshmërisë së vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Pretendimet në ankim kanë qenë për shkelje që cenonin në tërësi procesin. Po kështu, sipas kërkuesit, vlerësimi nga gjykata e apelit se padia është parashkruar, për shkak se është paraqitur përtej afatit 2-vjeçar, cenon parimin e disponibilitetit, për sa kohë ky pretendim ka rënë në dekadencë, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka legjitimuar cenimin e këtij parimi.

30. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se e drejta e mbrojtjes, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor, ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohej realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklarimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 7, datë 12.03.2010; nr. 12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas saj, çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër dhe gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen

që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 28, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjithashtu, në jurisprudencën e saj të vazhdueshme, Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Nga përmbajtja e akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues, Kolegji konstaton se kërkuesi në datën 11.02.2011 ka lidhur me një shoqëri sigurimi një kontratë sigurimi kasko për automjetin që ka pasur në pronësi. Në datën 27.02.2011 kërkuesi me automjetin e tij është përfshirë në një ngjarje, me pasojë vdekjen e një shtetasi, por edhe dëmtimin e automjetit të tij. Menjëherë pas kësaj ngjarje, mbështetur në kushtet e kontratës së sigurimit kasko, kërkuesi i është drejtuar shoqërisë së sigurimit për përfitimin e shpërblimit të dëmit që kishte pësuar automjeti i tij, përfaqësuesit e së cilës kanë kryer edhe veprimet përkatëse. Pavarësisht kësaj, sikundër edhe një kërkesë të datës 15.10.2012, kërkuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje nga siguresi. Në këto kushte, në mars 2013 ai i është drejtuar gjykatës me padi për përfitimin e dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit, në masën 1 000 000 lekë, si dhe interesat e paakorduar në kohë të saj. Në padinë e tij kërkuesi i është referuar kontratës së sigurimit kasko të datës 11.02.2011, ndërsa gjatë gjykimit, në parashtrimet e tij me shkrim, ka theksuar se në cilësinë e të siguruarit ka respektuar të gjitha kushtet e kësaj kontrate, ndërkohë që pala e paditur, në përputhje me kushtet e përgjithshme të saj, ka pasur detyrimin për ta dëmshpërblyer atë brenda 30 ditëve nga momenti i njoftimit të ngjarjes së sigurimit.

33. Padia e kërkuesit është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila e ka gjetur të drejtë prapësimin e siguresit të paditur, duke arsyetuar se, sikurse është provuar nga hetimi i prokurorisë, vendi ku ka ndodhur ngjarja nuk klasifikohet si rrugë automobilistike për lëvizjen e lirë të mjeteve motorike, rruga është e painventarizuar dhe ndodhet nën administrimin e ushtrisë si fushë aviacioni. Sipas pikës 4, shkronja “q”, të kushteve të kontratës kasko, përjashtohen nga mbulimi dëmet që shkaktohen kur mjeti kalon në shtigje rrugësh ose qarkullon në rrugë të pashtruara, të painventarizuara (jo për qarkullim mjeteve). Për pasojë, sipas gjykatës, kërkuesi nuk

ka qenë i mbuluar nga polica e sigurimit për kërkimin objekt gjykimi. Kërkuesi ka paraqitur ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke kërkuar prishjen e tij dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, për shkak se hetimi gjyqësor ka qenë i paplotë.

34. Ankimi i kërkuesit është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë në seancë gjyqësore. Në seancën gjyqësore të datës 12.05.2015, në prani të përfaqësuesit të kërkuesit dhe atij të siguruesit të paditur, të cilët kanë depozituar parashtrimet e tyre me shkrim. Krahas tyre, përfaqësuesi i të padituri ka paraqitur edhe një kopje të kontratës së sigurimit kasko të lidhur mes palëve ndërgjyqëse. Në vijim, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Sipas saj, e drejta e kërkuesit për të ngritur padi është parashkruar, pasi ajo është paraqitur në gjykatë pas kalimit të afatit 2-vjeçar nga ngjarja e dëmit. Po kështu, sipas asaj gjykate, referuar kushteve të kontratës së sigurimit kasko, siguruesi i paditur nuk mbart asnjë detyrim për pagimin e dëmit të shkaktuar automjetit të kërkuesit në kushtet kur vendi ku ka ndodhur ngjarja nuk klasifikohet si rrugë automobilistike për lëvizjen e lirë të mjeteve. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kërkuesi ka ushtruar rekurs, duke kërkuar prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

35. Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit me arsyetimin se nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara në ligj. Sipas saj, nga ana e gjykatave të faktit janë respektuar normat procedurale, të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit dhe nuk rezulton të ketë shkaqe të rënda procedurale, të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve. Ajo gjykatë është shprehur se nga aktet procedurale të gjykimit konstatohet se palëve iu është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj., duke u respektuar të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit jo vetëm ka riçelur hetimin për administrimin e kontratës, por u ka dhënë mundësi palëve të ngrenë pretendime e prapësime lidhur me vlerën provuese të saj dhe, në këtë mënyrë, ajo ka plotësuar të metat e hetimit të gjykatës së shkallës së parë, duke u dhënë përgjigje ezauruese pretendimeve e prapësimeve të të dyja palëve. Së fundi, ajo gjykatë ka arsyetuar se nga ana e gjykatave të faktit janë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material, se ato kanë bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, se kanë kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e kanë zgjidhur

mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ndërkohë që nuk konstatohet se vendimet e dhëna nga ato të vijnë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 16 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

36. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë standardet kushtetuese në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes të pasqyruara si më sipër, evidenton se dy gjykatat e faktit kanë shqyrtuar në themel shkaqet e padisë dhe të ankimit të kërkuarit. Ky i fundit ka qenë i pranishëm gjatë gjykimit, personalisht dhe nëpërmjet përfaqësuesit të zgjedhur, si dhe ka pasur mundësi të parashtrijë çështjen e tij, sikundër edhe të paraqesë prova që ka çmuar të nevojshme e të dobishme për interesat e veta. Po ashtu, ai ka pasur mundësi edhe për të kundërshtuar prapësimet e palës kundërshtare dhe provat e saj. Kontrata e sigurimit kasko, mbi të cilën kërkuari ka mbështetur të drejtën subjektive të kërkuar në padi, pavarësisht se nuk është paraqitur prej tij, por as nga i padituri, është pranuar si e tillë nga gjykata e shkallës së parë, ndërkohë që ajo është paraqitur më pas nga i padituri në gjykimin në apel, gjatë të cilit kërkuari nuk rezultoi të ketë parashtruar ndonjë kërkesë apo të ketë ngritur ndonjë çështje specifike në lidhje me të. Kolegji vë në dukje se procesi gjyqësor ka filluar me padinë e kërkuarit, i cili ka pretenduar të drejta ndaj palës tjetër pikërisht referuar kontratës së lidhur ndërmjet tyre, çka nënkupton dijeninë dhe njohjen e tij për përmbajtjen e saj. Për më tepër, përgjatë të gjithë procesit ai ka kërkuar respektimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve nga siguruesi i paditur sipas parashikimeve të kësaj kontrate.

37. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se ndonëse gjykata e apelit është shprehur se padia është paraqitur tej afatit ligjor 2-vjeçar, vlerësimi i saj për rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk është mbështetur vetëm në këtë shkak, por edhe në mosvërtetimin e së drejtës subjektive të pretenduar nga kërkuari sipas parashikimeve të kontratës së sigurimit kasko, duke u dhënë përgjigje në këtë mënyrë shkaqeve të ankimit të kërkuarit. Rregullsia në tërësi e procesit dhe vlerësimi i gjykatave të faktit për mosmarrëveshjen në fjalë është verifikuar dhe konfirmuar edhe nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit ka konstatuar se gjykatat e faktit kanë përmbushur detyrimet e tyre ligjore, duke i garantuar kërkuarit të gjitha aspektet e procesit të rregullt ligjor, përfshirë kontradiktoritetin, barazinë e armëve, të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të kërkuar e paraqitur prova, të drejtën e mbrojtjes, dhe në përfundim, ka konkluduar mungesën e shkaqeve që e bëjnë rekursin të pranueshëm. Vetëm fakti se gjykatat kanë dhënë vendime që nuk përkojnë me interesat e kërkuarit, nuk do të thotë se atij nuk i është garantuar e drejta e mbrojtjes apo aspektet e tjera të procesit të rregullt ligjor.

38. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes është haptazi i pabazuar.

*Ç. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

39. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe jologjik, pasi, nga njëra anë, pranon shkeljen e lejuar nga gjykata e shkallës së parë në lidhje me mosadministrimin e provës vendimtare, konkretisht të kontratës së sigurimit kasko dhe, nga ana tjetër, ligjëron vendimmarrjet e gjykatave të faktit. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar me hollësi e argumente se përse nuk i merr parasysh pretendimet në rekurs të kërkuesit, ndërsa ka dhënë konkluzione kategorike e të rrumbullakosura, duke keqinterpretuar faktet dhe ligjin. Gjithashtu, sipas tij, megjithëse Gjykata e Lartë shprehet se shkelja nga gjykata e shkallës së parë është rregulluar nga “riçelja e hetimit gjyqësor” prej gjykatës së apelit, nga procesverbali gjyqësor nuk rezulton një gjë e tillë.

40. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ai, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, sipas Gjykatës, vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, zbatimi i standardit të arsytimit është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre.

41. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesi, i cili ka kërkuar shpërblimin e dëmit bazuar në kontratën e sigurimit kasko. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit e kanë rrëzuar kërkimin e tij me argumentin, ndër të tjera, se dëmtimi i automjetit është shkaktuar ndërsa ai po qarkullonte në një vend që nuk mbulohej nga

kjo kontratë. Gjykata e Lartë, referuar akteve dhe provave të dosjes gjyqësore, ka konstatuar se gjykatat kanë respektuar parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, kanë zbatuar drejt normat procedurale dhe materiale, si dhe kanë kryer një analizë juridike të plotë të provave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me praktikën e vetë Gjykatës së Lartë, duke evidentuar faktin se shkelja e kryer nga gjykata e shkallës së parë në mosadministrimin e kontratës është riparuar nga gjykata e apelit. Nga ana tjetër, ndonëse nga përmbajtja e procesverbal gjyqësor me shkrim të paraqitur nga kërkuesi dhe e vendimit të gjykatës së apelit nuk pasqyrohet që ajo të jetë shprehur për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin si provë të kontratës, në kushtet e mosparaqitjes së transkriptimit të procesverbalit të regjistrimit të mbajtur me mjete të regjistrimit audio, si dhe për sa kohë është fakt se kontrata është depozituar nga i padituri në gjykimin në apel, sërish ky pohim i Gjykatës së Lartë nuk përbën mangësi të atillë që të cenojë standardin e arsytimit të vendimit të saj apo të ketë cenuar ndonjë të drejtë kushtetuese të kërkuesit, në kushtet kur edhe pas marrjes dhe vlerësimit të kontratës nga gjykata e apelit, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë u gjet i drejtë nga gjykatat më të larta.

42. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, vendimi i Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit, si dhe arsyet mbi të cilat ajo gjykatë ka dhënë vendimin e saj, në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Përkundër pretendimit të kërkuesit, vendimi i asaj gjykate nuk rezulton të jetë kontradiktor, jologjik apo me pamjaftueshmëri argumentesh për të kuptuar lidhjen e arsytimit me dispozitivin e vendimit. Për rrjedhojë, vendimi objekt kundërshtimi përmbush mjaftueshëm standardet kushtetuese të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe pretendimi i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

43. Nën dritën e analizës së mësipërme, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor janë haptazi të pabazuara, për rrjedhojë edhe pretendimet e ndërlidhura, për cenimin e së drejtës së pronës dhe parimit të barazisë para ligjit, janë haptazi të pabazuara.

44. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.